

NJOFTIM PËR SUBJEKTIN E RIVLERËSIMIT, Z. IZET KADANA

12/20/2018

Komisioni i Pavarur i Kualifikimit njofton se, pas shqyrtimit të dokumentacionit dhe zhvillimit të seancës dëgjimore më datë 18.12.2018 për subjektin e rivlerësimit, z. Izet Kadana, bazuar në ligjin nr. 84/2016, sot, më datë 20.12.2018 vendosi:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, Izet Kadana kryetar i Gjykatës së Rrethit Pukë.

Vendimi i arsyetuar me shkrim nga trupa gjyquese e kryesuar nga z. Lulzim Hamitaj, znj. Firdes Shuli relatores, znj. Xhensila Pine anëtare, do t'u njoftohet subjektit të rivlerësimit, komisionerëve publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve.

Ndaj këtij vendimi, mund të ushtrohet ankimi pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.